




Programi i Partneritetit Evropian me Komunitat

Raporti vjetor i EU PROGRES

Korrik 2012 - Qershor 2013



Program finansira EU



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



Sprovodi program



Program finansira EU



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



UNOPS

Sprovodi program

eu progres

Program evropskog partnerstva sa opštinama

Rezyme

Në përputhje me rekomandimet e autorëve të Evaluimit në gjysmën e kohëzgjatjes së Programit të partneritetit evropian me komunat, implementimi i EU PROGRES-it është zgjatur për nëntë muaj, deri në mars të vitit 2014, për shkak të realizimit të qëllimeve të caktuara, duke vazhduar aplikimin e metodologjisë së ndihmës së pakthyeshme, forcimin e efekteve të intervenimit dhe monitorimin e rezultateve të arritura.

Në fund të vitit të tretë të zbatimit të Programit, janë realizuar 146 (62%) prej gjithsej 234 projekteve të kontraktuara, ose 33% më shumë se sa në periudhën e mëparshme raportuese; implementimi i 44 (19%) projekteve ka shkuar sipas planit kurse implementimi i 34 (15%) projekteve është zhvilluar me vonesë që me vete bartin rreziqe të vogla, përderisa implementimi i dhjetë projekteve (4%) është ndërprerë. Gjatë periudhës raportuese gjithsej janë ndarë 5.343.286 euro, kurse Programi deri në fund të qershorit 2013 ka shpenzuar 11.255.009 euro, ose 68.64% të buxhetit të vet. Është kontraktuar sufinansimi i më shumë se tre milion euro kurse gjysma e kësaj shume është realizuar deri në qershor të vitit 2013.

Megjithkëtë, na mbetet punë e rëndësishme në ambientin i cili është i ndërlikuar dhe i nënshtruar ndryshimeve të cilat ndikojnë në Program në mënyrë të shumëfishtë.

I vetëdijshëm për sfidat të cilat kanë mundur të sjellin zgjedhjet në vitin 2012, EU PROGRES-i në Planin e vet ka parashikuar mundësinë e vonesës. Por, ndryshimet e mëdha të cilat kanë vijuar në periudhën pas zgjedhjeve dhe kanë vazhduar të zhvillohen edhe një vit pas mbajtjes së tyre, kanë ndikuar në mënyrë të pavolitshme në Program dhe kanë ngadalësuar disa aktivitete. Në 17 komuna ka ardhur deri te ndryshimi në strukturën e koalicioneve udhëheqëse, në disa pre tyre ka pasur ndryshime edhe nga disa herë, kurse duket se vetqeverisjet e reja, të cilat tani përbëhen nga kundërshtarët e mëparshëm politik, janë të brishta dhe të ngarkuara me mosbesim, skepticizëm dhe çështje të pazgjidhura nga e kaluara. Kjo në mënyrë shtesë i ka ngarkuar të punësuarit, të cilëve iu nevojitet shumë më tepër kohë që (përsëri) të vendosin marrëdhënie dhe të sigurojnë vazhdimësi të realizimit të projekteve në kohëzgjatje prej disa javëve, kurse në disa raste edhe nga disa muaj.

Programi, edhe përkundër kësaj ka vazhduar të aplikojë metodologjinë e ndihmës së pakthyeshme në 88% të projekteve, që kontribuojnë në forcimin e kapaciteteve dhe ndjenjës së „pronësisë“ ndaj tyre. Edhe pse indikatorët e caktuar vërtetojnë efektshmërinë e kësaj metodologjie, sepse, për shembull, nevojitet më pak kohë për përgatitjen e pakove të tenderit si dhe revidimet janë më të mira, ato njëkohësisht paraqesin edhe sfidë. Shumë shpesh vie deri te vonesa në zbatimin e aktiviteteve për shkak të veprimeve tjera të prokurimeve publike, kapaciteteve të kufizuara për menaxhimin e projekteve ose për shkak të vështirësive në përmbushjen e obligimit të sufinansimit. Kjo ka sjellur deri te zgjatja e afateve për implementimin e 65% të projekteve dhe gjithsej 197 amandamenteve të kontratave për ndihmë të pakthyeshme.

Rreziqet siç janë vërshimet, dimri shumë i fortë ose marrëdhëniet e dobëta në mes të qeverisjeve lokale dhe republikane mund të rrezikojnë disa projekte të infrastrukturës. Përparimi i EU PROGRES-it është solid përkundër sfidave serioze dhe planifikon të përfundojë të gjitha aktivitetet në periudhën e mbetur të kohëzgjatjes së Programit.

Efektet e shumicës së aktiviteteve të implementuara janë të mira dhe ato në mënyrë të vilitshme kanë ndikuar në jetën e popullatës në jug dhe jugperëndim të Serbisë. Të



Program finansira EU



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra
Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



UNOPS

Sprovodi program

eu progres

Program evropskog partnerstva sa opštinama

përmendim 41 projekte të vogla të infrastrukturës, prej të cilëve 29 janë implementuar. Me ato është avancuar infrastruktura e biznesit, menaxhimi i mbeturinave, furnizimi me ujë, efikasiteti i energjisë si dhe kushtet e arsimit dhe sporti, mbrojtja shëndetësore dhe pozita e të rinjëve.

Puna në projektet e infrastrukturës karakterizohet edhe me një kualitet të posaçëm. Aplikimi i parimeve të menaxhimit të mirë dhe operacionalizimi i përgjegjës, efikasitetit, efektshmërisë, ndalesës së diskriminimit dhe pjesëmarrja në përmbajtjen e qartë dhe praktike në mënyrë të posaçme kanë kontribuar në sundimin e ligjit dhe përpjekjet antikorruptive. Janë përgatitur 35 rregulla lokale kurse janë duke përfunduar edhe 20 rregulla me të cilat sigurohet dobi e përbashkët nga pajisja e re dhe objektet e reja sportive, mosekzistimi i diskriminimit me rastin e regjistrimit të fëmijëve në çerdhe, etj. EU PROGRES-i ka lehtësuar organizimin e menaxhimit për të gjitha projektet ndërkomunale/regjionale, si Deponinë Banjica, Pemtaria në Qarkun e Pçinjës, Zona e Gjellbër në Leskoc, Qendra regjionale për zhvillimin e bujqësisë në Peshter dhe Deponinë regjionale në Qarkun e Pçinjës Meterisi. Mundësia që këto projekte regjionale të jenë të suksesshme do të ishte më e vogël në qoftë se nuk do të ekzistonte një organizim i tillë. Ekspertët zviceran kanë vlerësuar të gjitha këto trende dhe praktika pozitive në raportin e prillit të vitit 2013.

Pa dyshim që janë bërë shumë depërtime në përpjekjet e EU PROGRESit që të kontribuojë në stimulimin e investimeve dhe hapjen e vendeve të reja të punës që janë me rëndësi të madhe për të gjithë. Për shkak të ilustrimit, përkrahjen të cilën e ka ofruar Programi në Vranjë në hartimin e dokumentacionit planor dhe teknik për Zonën Industriale dhe hapjen e Shërbimit Gjithçka në një vend, me të cilin koha e duhur për marrjen e lejes për ndërtim është shkurtuar, si dhe projekti i brendimit kanë qenë komplementar me përpjekjet e Qeverisë së Republikës së Serbisë dhe Qytetit që të nxisin investimet e prodhuesit italian të këpucëve Geox dhe prodhuesit të mobiljeve Ditte Italia. Pritet që investimet e këtyre dy kompanive do të arrijnë 29 milion euro dhe që ato do të punësojnë më shumë se 2.200 persona.

Nëntë projekte të brendimit merren me fusha të ndryshme. Disa përkrahin zhvillimin e turizmit (Vllasina, Zlatar dhe Golia), organizimin e festivaleve (Ditët e Kumbullës në Bllacë dhe Festivali i Vishnjeve në Leskoc), përderisa disa kanë për qëllim krijimin ose përmirësimin e imazhit të qytetit (Novi Pazar dhe Vranja). Të paktën dy projekte (Brendimi i produkteve të Peshterit dhe Promovimi i Vranjës si qytet i përshtatshëm për investime) do të kontribuojnë në rritjen e aktiviteteve ekonomike.

EU PROGRES me sukses ka realizuar disa aktivitete të drejtuara në forcimin e kapaciteteve të qeverisjeve lokale kurse shumica prej tyre janë të rëndësishme për avancimin e konkurrencës së komunave. Në katër komuna janë formuar shërbimet Gjithçka në një vend, të cilat kanë për qëllim zvogëlimin e kohës së nevojshme për dhënien e lejes për ndërtim nga 96 në 77 ditë. Është bërë përparim i rëndësishëm në fushën e dokumentacionit urbanistik dhe planor. Një elaborat, shtatë plane të rregullimit gjeneral dhe 19 plane të rregullimit detal janë aprovuar ose gjenden para aprovimit. Komunave në bazë të dokumentacionit teknik dhe planor deri më tani iu janë lejuar mjete në shumë prej **1,6 milion euro**.

Përpjekjet në avancimin e menaxhimit të financave publike kanë qenë të frytshme. Ka përfunduar aplikimi i buxhetimit programor dhe planifikimi i investimeve kapitale në pesë komuna. Përkrahja e azhurimit të bazave të të dhënave të Administratave tatimore lokale në 11 komuna jo vetëm që ka sjellur deri te rritja e shumës së përgjithshme të vendimeve për tatim në pasuri për rreth 700.000 euro, ose për 37,3% mesatarisht, por nga obliguesit tatimor janë grumbulluar rreth 230.000 euro më shumë në bazë të tatimit në pasuri.

Ky Program financohet nga Unioni Evropian, Qeveria e Zvicrës dhe Qeveria e Serbisë dhe implementohet nga UNOPS, në partneritet me 25 komunat e Serbisë Jugore dhe Jugperëndimore.

www.euprogres.org



Program finansira EU



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra
Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



UNOPS

Sprovidi program

eu progres

Program evropskog partnerstva sa opštinama

Marrëdhënia në mes të shpenzimeve dhe dobisë së këtij aktiviteti është gjithashtu e shkëlqyeshme sepse në këtë aktivitet janë investuar 129.000 euro kurse deri në fund të periudhës së implementimit janë grumbulluar gati dyfish më shumë mjete në bazë të tatimit në pasuri.

Është regjistruar përparim edhe në vendosjen e kornizës institucionale lidhur me administratën, posaçërisht në pikëpamje të barazisë gjinore, luftës kundër korrupsionit, pjesëmarrjes së qytetarëve dhe të drejtave të pakicave. Përveç formimit të mekanizmave për barazi gjinore në 12 komuna, nëntë komuna kanë aprovuar Planet e integritetit, të cilat paraqesin mekanizma të rëndësishme për luftë kundër korrupsionit, 12 komuna kanë implementuar buxhetimin participues kurse tri komuna kanë vendosur të institucionalizojnë këtë veprim (përderisa 11 komuna kanë nënshkruar Memorandumin për bashkëpunim për formimin e ekipeve për buxhetim participues). Është duke përfunduar institucionalizimi i ndihmës juridike falas në Novi Pazar dhe në Prokuplje.

Vlerësohet se aktivitetet e EU PROGRES-it nga fillimi i intervenimit në korrik të vitit 2010 në mënyrë direkte kanë pasur ndikim pozitiv te 9.106 pjesëtar të grupeve të rrezikuara të popullatës, duke përfshirë Romët, personat me invaliditet, gratë dhe të moshuarit. Përkrahja ka qenë multidimensionale, nga mundësimi i qasjes në shërbimet publike, siç janë arsimit dhe ndihma sociale, deri te sigurimi i ujit të pijshëm dhe punësimi. Katër Shërbime këshilluese për qytetarë (ShKQ) kanë ofruar ndihmë juridike për 2.375 shfrytëzues në mesin e të cilëve edhe rreth 500 Romë, që të sigurojnë dokumentacionin personal, realizojnë të drejtat e veta për ndihmë sociale, arsimim, etj. Janë realizuar aktivitete të ndryshme të orientuara në përmirësimin e kushteve të vështira në të cilat jetojnë Romët: për shembull, 100 shfrytëzues Romë në Vranjë janë lidhur në ujësjellës kurse 1.500 në Surdulicë do të lidhen në ujësjellës në gusht; projekti i orientuar në ndërmarrësinë e Romëve do të mundësojë punësimin e 29 personave.

Njëmbëdhjetë vizita të nivelit të lartë (duke përfshirë edhe tri vizita të ambasadorëve), numër tri herë më i madh i komunikatave për shtyp nga ai i parashikuar në Planin vjetor, dhe më shumë se 1.160 raporte afirmative (në krahasim me 200 të planifikuara) dukshëm tregojnë për dukshmërinë e iniciativave të cilat i përkrahin EU dhe Zvicra si dhe në atë që mesazhet për planifikimin, rritjen shoqëro-ekonomike si dhe domosdoshmërinë e ruajtjes së stabilitetit dhe vizionit të fortë të zhvillimit kanë arritur deri te publiku shumë më i gjerë. Faqja e internetit dhe bilteni i Programit gjithashtu kanë kontribuar në imazhin pozitiv të donatorëve dhe raportimin mbi punën e EU PROGRES-it. Faqen e internetit në periudhën prej korrikut 2012 deri në fund të qershorit 2013 rreth 23.697 e kanë vizituar 42.071 herë, ose për 30% më shumë se sa në periudhën e mëparshme raportuese (në krahasim me 10.000 vizitat e planifikuara). Është bërë distribuimi i tre bilteneve tremujore dhe një bilten vjetor EU PROGRES Risitë në gjuhën angleze dhe serbe, secili në më shumë se 1.100 adresa elektronike. Por, dy kapmanja për ngritjen e vetëdijes më së shumti kanë kontribuar në zgjerimin e informatave kualitative për menaxhimin e mirë, temës transversale të tërë Programit, si dhe për procesin e qasjes në EU, dobite nga anëtarësia dhe obligimet të cilat ajo bartë.

Programi nuk do të arrinte të realizojë asnjë sukses pa partneritetet e forta të cilat i ka krijuar. Këtë e kanë njohur edhe dy qytetet dhe shtatë komunat (Leskoci, Vranja, Ivanjica, Bosilegradi, Rashka, Trgovishta, Vllasotinca, Lebana dhe Zhitovragja) të cilat EU PROGRES-it i kanë ndarë mirënjohjet (më të larta) qytetare/komunale për kontribut në zhvillimin lokal. Përkrahja e përhershme strategjike dhe lidhshipi janë siguruar me Udhëheqjen e Këshillit Drejtues të Programit nga Zyra për Integritet Evropian të Republikës së Serbisë. Është realizuar një synergie e fortë me Ministrinë e Zhvillimit Regional dhe Vetqeverisjes Lokale,

Ky Program financohet nga Unioni Evropian, Qeveria e Zvicrës dhe Qeveria e Serbisë dhe implementohet nga UNOPS, në partneritet me 25 komunat e Serbisë Jugore dhe Jugperëndimore.

www.euprogres.org



Program finansira EU



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



UNOPS

Sprovodi program

euprogres

Program evropskog partnerstva sa opštinama

Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoratin e ujërave të Ministrisë së Bujqësisë, Pyltarisë dhe Ujësjetllësit, Zyrës për Zhvillim të Qëndrueshëm të Rajoneve të Pzhvilluara, Trupit Koordinues për të Drejtat e Njeriut dhe të Pakicave dhe Këshilleve Nacionale të Pakicave Nacionale, si dhe bashkëpunimi me Minisrinë e Mbrojtjes së Ambientit Jetësor, Agjencionit për luftë kundër korrupsionit, Mbrojtësin e Qytetarëve dhe shumë organe të tjera shtetërore.

Aktivitetet realizohen me hov të madh në mënyrë që gjatë nëntë muajve deri në fund të Programit të vazhdohet me zbatimin e rekomandimeve të Misionit të Monitorimit të Unionit Evropian dhe Ekspertëve Zvicëran për menaxhim të mirë, ka avancuar sistemin e përcjelljes dhe evaluimit dhe ka demonstruar rëndësinë e iniciativave zhvillimore siç është kjo. Me përpjekje të përbashkëta dhe dedikim të vërtetë në arritjen e qëllimeve të përbashkëta, të gjithë partnerët kontribuojnë në lëvizjen e jugut dhe jugperëndimit nga harta e komunave më të pzhvilluara, me prirje ndaj konflikteve në një rajon i cili stimulon investitorët me fuqinë e vet punëtore të kualifikuar dhe me potencial për rritje shoqëro-ekonomike nga i cili i tërë vendi do të kishte dobi.